



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE \* MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA \* SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 40 të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.07.2003 merr:

## **V E N D I M**

### **PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES KOMUNALE TË RENDIT KOMUNAL 01. nr. 110-2914 e datës 12.12.2001**

I

Ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja komunale për rendin komunal 01. nr. 110-2914 e datës 12.12.2001 dhe atë:

NENI 3.7, Ndryshohet dhe thot:

Për ndriçimin e rrugëve dhe trotuareve kujdeset ndërmarrja, e cila e fiton tenderin. Të gjitha rrugët (kryesore dhe dytësore), si dhe rrugët me rëndësi më të vogël në të cilat gjendet ndriçimi publik, natën duhet të jenë të ndriçuara me ndriçim përkatës, e shprehur në luks. Shtyllat e ndriçimit publik duhet të jenë stabile, në pozitë vertikale, në mënyrë që të mos cenojnë sigurinë e mjedisit përkatësisht kalimtarëve dhe të pasurisë ku janë vendosur, si dhe shtyllat duhen të jenë të mbrojtura si duhet nga aspekti i elektricitetit, përkatësisht kapakët e sigursave duhet të jenë në gjendje të rregullt në çdo vend.

NENI 3.8, Ndryshohet dhe thot:

Heqja dhe deponimi i bërllokut shtëpiak, mbeturinave dhe i bërllokut nga sipërfaqet publike, si dhe largimi i fekaleve, bëhet nga ndërmarrja e autorizuar nga Komuna (në tekstin e mëtejme: Ndërmarrja e autorizuar), dhe atë si vijon:

- Ndërmarrja e autorizuar e ka për detyrë që rregullisht dhe si duhet të pastrojë enët e bërllokut (kovat, konteinerët dhe pjesët e tjera), dhe duhet të ketë kujdes që në rastin e largimit të bërllogut shtëpiak dhe të mbeturinave që në oborret e ndërtesave dhe në sipërfaqet publike të mos shkapërderdhen mbeturinat dhe bërlloku;

- Ndërmarrjet, Organizatat, Institucionet e personat tjerë juridik si dhe qytetarët, e kanë për detyrë të sigurojnë enë përkatëse për grumbullimin e mbeturinave, ndërsa vendosja dhe shpërndarja e enëve të tipizuara për mbeturina (konteinier) bëhet nga ndërmarrja e autorizuar.

- Mbeturinat shtëpiake duhet të grumbullohen në enët e tipizuara për mbeturina (kova, konteiner e të ngjashme), të cilat duhet të kenë kapakët e tyre dhe vendosjen jashtë sipërfaqeve të trafikut publik në vendet e mbrojtura dhe të përshtatshme për bartje dhe duhet të mirëmbahen e të zbrazen rregullisht në thasë najlloni e të ngjajshme, të përshtatshme për bartje.

- Ndërmarrja e autorizuar ka për detyrë që bërllokun shtëpiak dhe mbeturinat nga shfrytëzuesit e shërbimeve t'i largoj më së paku një herë në javë në kohë të caktuar, bërllokun e mbeturinat e rrugës çdo ditë pas pastrimit, bërllokun nga shitoret dhe dyqanet zejtare e të tjera, 2 herë në javë dhe jashtëzakonisht sipas nevojës. Organi kompetent i Administratës Komunale në rastet e jashtëzakonshme kohore dhe për shkaqe të tjera të

arsyeshme, mund të caktojë që në pjesët e caktuara të qytetit, bërlloku dhe mbeturinat shtëpiake të largohen shumë herë;

- Ndërmarrjet e autorizuara nuk do t'ju kryejnë shërbimet te largimit të mbeturinave ndërmarrjeve shoqërore, private, publike instiucioneve, enteve, shitoreve private që nuk janë të paisura me mjete përkatse për vendosjen e mbeturinave;

- Largimi i bërllokut shtëpiak, fekaljeve dhe ujrave të ndotura nga nevojtoret e fushës dhe gropat septike mund të bëhen vetëm me mjete të destinuara dhe të paisura për këtë qëllim, për tu mos shkaktuar shkapërderdhja e bërllogut dhe e mbeturinave si dhe derdhja e fekaleve dhe ujërave të tjera të ndotura në sipërfaqet publike;

-Ndërmarrja e autorizuar ka për detyrë që organeve të Inspeksionit kompetent komunal dhe Inspeksionit të rugëve publike, më së largu deri më 15 të muajit, t'ju paraqes planin e largimit të bërllokut shtëpiak dhe mbeturinave për muajin e ardhshëm në verifikim.

### **MBIKËQYRJA**

NENI 10, Ndryshohet dhe thot:

Zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje e bënë organi i Administratës komunale kompetente për shërbime publike, ndërsa mbikëqyrjen inspektionale e bënë Sektori i Inspeksionit Komunal të Drejtoratit për Inspeksion dhe Policia.

### **GJOBAT**

NENI 11- Ndryshohet dhe thot:

11.1 Më gjobë prej 250 deri 600 Euro, do të gjobitet për kundërvajtje:ndërmarrja private, ndërmarrja komunale dhe ajo shoqërore, instutucionet e administrimit të përkohshëm, entet, shkollat, institucionet tjera si dhe personat tjerë juridik, nëse vepron në kundërshtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje.

11.2 Me gjobë prej 150 deri 250 Euro, do të gjobitet për kundërvajtje qytetari, pronari i dyqanit hotelier, tregtar dhe zejtar, nëse vepron në kundërshtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje.

11.3 Me gjobë prej 100 Euro, e cila arkëtohet në vendin e ngjarjës (gjoba mandatore) do të gjobitet për kundërvajtje qytetari dhe pronari i dyqanit, nëse vepron në kundërshtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje.

### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

NENI 12 - Ndryshohet dhe thotë:

12.1 Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdesen Drejtorati për Shërbime Publike, Transport e Ambient, Drejtorati i Inspeksionit dhe Policia.

## **II**

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

Nr \_\_\_\_\_ Dt \_\_\_\_\_

**KRYETARI**  
**Ismet Beqiri**